



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3626/ 8 prot.

Datë 15.01.2025

V E N D I M
Nr. 75/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.01.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik Sali Vrenezi P.F në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-29086-11-12-2024, me objekt: “Blerje lënde djegëse (Dru), Bashkia Bulqizë” me fond limit 6,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 25.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik Dritan Xheka P.F në procedurën e mësipërme të prokurimit

Ankimues:

Sali Vrenezi P.F me NIPT L46322702U dhe adresë: Rruga Lagjja Treg, Rruga “Ismail Feta”, (shesh magazinimi lënde drusore tek ish parku i mallrave), Peshkopi, Dibër

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Bulqizë me adresë: Lagjja “Minatori” Bulqizë

Subjekte të Interesuara:

Ditan Xheka, me NIPT L56503401V dhe adresë: Dibër, Shupenzë, SHUPENZË, Lagjja Qendër, rruga e Komunës, ndërtesa nr.1, kati i parë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.11.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-29086-11-12-2024, me objekt: “Blerje lëndë djegëse (Dru), Bashkia Bulqizë” me fond limit 6,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 25.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.

II.2. Në datë 25.11.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton, se në datën 26.11.2024, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

- Sali Vrenezi P.F	5 800 000	lekë	kualifikuar
- Dritan Xheka P.F	5 940 000	lekë	kualifikuar

II.4. Referuar sistemit të prokurimit elektronik autoriteti kontraktor në rubrikën “Kërkesa” me datë 26.11.2024 i ka kërkuar operatorit ekonomik Sali Vrenezi P.F në cilësinë e operatorit ekonomik të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit pranë autoritetit kontraktor me datë 27.11.2024 sipas parashikimeve të nenit 26 pika 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për prokurimin publik i ndryshuar” me përmbajtje si vijon; *“Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse (dru), Bashkia Bulqizë” të zhvilluar me datë 25.11.2024 jeni klasifikuar i pari në renditje. Ju lutem paraqitni dokumentacionin origjinal ose kopje të njëzuar me origjinalin sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim si dhe në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021 neni 26/6 me kërkesë të autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë fizikisht pranë Bashkisë Bulqizë dokumentacionin provues të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës të dorëzuara në rrugë elektronike. Afati përfundimtar për sjelljen e dokumentacionit do të jetë deri me datë 27.11.2025 ora 13:00. Mos dorëzimi në kohë i dokumentacionit përbën shkak për skualifikim.”*

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton, se në datën 03.12.2024, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës, duke i njoftuar operatorët ekonomikë me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

- Sali Vrenezi P.F	5 800 000	lekë	skualifikuar
- Dritan Xheka P.F	5 940 000	lekë	kualifikuar

II.5.1. Operatori ekonomik Sali Vrenezi P.F shpk rezulton i skualifikuar për arsye se: *“Pas njoftimit të operatorit i kualifikuar i pari në renditje me ofertën ekonomike më të ulët, rezulton që në dokumentacionin e dorëzuar nuk është sjellë pranë autoritetit kontraktor: 1-Vërtetimi i prokurorisë mbi gjendjen gjyqësore si dhe dëshmia e penalitetit sipas formularit të vetëdeklarimit 2-Vërtetimi i debisë për shlyerjen e energjisë elektrike është fotokopje e panoterizuar e cila nuk i korrespondon faturës koherente të kërkuar në dst. Kapaciteti teknik Kriteri 2.3.3 në Dst për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publik duhet të paraqesë dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, certifikatën, siguracionin e mjetit si dhe certifikatën për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme). Për sa më sipër referuar këtij kriteri certifikata e transportit për mallra brenda vendit rezulton fotokopje e panoteruar”*.

II.6. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se me 06.12.2024 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak të procedurës së mësipërme të prokurimit ku rezulton fitues operatori ekonomik Dritan Xheka P.F.

II.7. Në datën 12.12.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4879, protokolluar në datën 12.12.2024 me nr. 3626/2024 protokollin e operatorit ekonomik Sali Vrenezi p.f për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-29086-11-12-2024, me objekt: “Blerje lënde djegëse (Dru), Bashkia Bulqizë” me fond limit 6,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 25.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik Sali Vrenezi P.F në procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe kualifikimin e operatorit ekonomik Ditan Xheka P.F.

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3626/2 prot., datë 13.12.2024.

II.9. Nëpërmjet shkresës me nr.6196 prot., datë 16.12.2024 protokolluar me tonën nr.3626/3 prot., datë 18.12.2024, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimin nr. 1, datë 16.12.2024 lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, nga ku rezulton, se KSHA e autoritetit kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke argumentuar “[...]”

Komisioni i shqyrtimit të ankesave u mblodh me datë 16.12.2024 për shqyrtimin e ankesës së bërë nga Sali Vrenezi P.F me numër Nipti L46322702U, nga ana e Komisioni të shqyrtimit të ankesave pasi lexoi me kujdes ankesën e bërë nga operatori ekonomik, Komisioni konstatoi si më poshtë:

1. Në seksionin 11: Përshkrimi i ankesës, pika 3 rrethanat dhe faktet, operatori thekson: “Me datë 03.12.2024 u njoftuam nga AK, Bashkia Bulqizë që oferta jonë për tenderin me objekt: “Blerje lënde djegëse (Dru), Bashkia Bulqizë” është skualifikuar për mosdorëzim dokumentacioni të kërkuar në kohë, konkretisht: Dëshmi penaliteti, vërtetim debie i OSHEE, vërtetim i prokurorisë, leja e transportit për mallra brenda vendit nuk është sjellë origjinal, por fotokopje.

Në dst citohet qartë që çdo dokument i Operatorit Ekonomik duhet të jetë origjinal ose i njësuar me të, që do të thotë i noterizuar dhe jo fotokopje. Në lidhje më pikën që kërkon skualifikimin e OE Dritan Xheka, ju sqarojmë si më poshtë vijon: Legjislacionit Prokurimit Publik citon që Autoriteti ose enti kontraktor është i detyruar të vërë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës. Autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni jo më vonë se 5 ditë nga marrja e vendimit: a) çdo kandidat të pasuksesshëm për arsyet e refuzimit të pjesëmarrjes së tij në tender: b) çdo kandidat, i cili nuk është renditur për në fazën e dytë, kur autoriteti ose enti kontraktor ka përdorur uljen e numrit të kandidatëve: c) çdo ofertues të pasuksesshëm për arsyet e refuzimit të ofertës së tij: çdo ofertues të suksesshëm, që ka paraqitur një o ertë të vlefshme, për Klasifikimin e ofertës së përzgjedhur.

Porsa më sipër nuk është në të drejtën e OE që të kërkojë skualifikimin e një Operatori të kualifikuar.

Sa me sipër kërkesave të paraqitura nga operatori ekonomik, komisioni i shqyrtimit të ankesave

VENDOS:

1. Mos pranimin e kërkesës së operatorit ekonomik sepse ai nuk ka sjellë të gjitha dokumentet e kërkuara në DST, si dhe nuk është e drejta e OE të kërkojë skualifikimin e një operatori të kualifikuar.

II.10. Me shkresën nr. 3626/4 prot., datë 08.01.2025 KPP ju drejtua autoritetit kontraktor me kërkesën si më poshtë: “[...] Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar në KPP informacion për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, por autoriteti kontraktor duhet të dërgojë të plotë në origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik Sali Vrenezi P.F pranë autoritetit kontraktor si operator ekonomik i kualifikuar i pari (bazuar në vlerësimin e kryer nga KVO me datë 26.11.2024) sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.”

II.11. Me shkresën nr. 100/1 prot., datë 10.01.2025 protokolluar me tonën me nr. 3626/5 prot., datë 13.01.2025 autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP informacionin e kërkuar.

II.12. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrative nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 të LPP-së.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues Sali Vrenezi mbi skualifikimin e tij nga procedurat e prokurimit me arsyen se *“Pas njoftimit të operatorit i kualifikuar i pari në renditje me ofertën ekonomike me të ulët, rezulton që në dokumentacionin e dorëzuar nuk është sjellë pranë autoritetit kontraktor: 1-Vërtetimi i prokurorisë mbi gjendjen gjyqësore si dhe dëshmia e penalitetit sipas formularit të vetëdeklarimit”* KPP vëren se,

III.2. Në datën 25.11.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.3 .Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton, se në datën 26.11.2024, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

- Sali Vrenezi P.F	5 800 000	lekë	kualifikuar
- Dritan Xheka P.F	5 940 000	lekë	kualifikuar

III.4. Referuar sistemit të prokurimit elektronik autoriteti kontraktor në rubrikën “Kërkesa” me datë 26.11.2024 i ka kërkuar operatorit ekonomik Sali Vrenezi P.F në cilësinë e operatorit ekonomik të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit pranë autoritetit kontraktor me datë 27.11.2024 sipas parashikimeve të nenit 26 pika 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për prokurimin publik i ndryshuar” me përmbajtje si vijon; *“Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse (dru), Bashkia Bulqizë” të zhvilluar me datë 25.11.2024 jeni klasifikuar i pari në renditje. Ju lutem paraqitni dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim si dhe në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021 neni 26/6 me kërkesë të autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë fizikisht pranë Bashkisë Bulqizë dokumentacionin provues të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës të dorëzuara në rrugë elektronike. Afati përfundimtar për sjelljen e dokumentacionit do të jetë deri me datë 27.11.2025 ora 13:00. Mos dorëzimi në kohë i dokumentacionit përbën shkak për skualifikim.”*

III.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimes rezulton, se në datën 03.12.2024, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës, duke i njoftuar operatorët ekonomikë me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

- Sali Vrenezi P.F	5 800 000	lekë	skualifikuar
- Dritan Xheka P.F	5 940 000	lekë	kualifikuar

III.6. Operatori ekonomik Sali Vrenezi p.f shpk rezulton i skualifikuar për arsye se: *“Pas njoftimit të operatorit i kualifikuar i pari në renditje me ofertën ekonomike me të ulët, rezulton që në dokumentacionin e dorëzuar nuk është sjellë pranë autoritetit kontraktor: 1-Vërtetimi i prokurorisë mbi gjendjen gjyqësore si dhe dëshmia e penalitetit sipas formularit të vetëdeklarimit 2-Vërtetimi i debisë për shlyerjen e energjisë elektrike është fotokopje e panoterizuar e cila nuk i korrespondon faturës koherente të kërkuar në dst. Kapaciteti teknik Kriteri 2.3.3 në Dst për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publik duhet të paraqesë dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, certifikatën, siguracionin e mjetit si dhe certifikatën për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme). Për sa më sipër referuar këtij kriteri certifikata e transportit për mallra brenda vendit rezulton fotokopje e panoteruar”.*

III.7. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se më 06.12.2024 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak të procedurës së mësipërme të prokurimit ku rezulton fitues operatori ekonomik Dritan Xheka P.F.

III.8. Neni 24, pika 1, *“Komisioni i prokurimit Publik”* i Ligjit 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, parashikon se: *“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.*

III.8.1. Neni 30, pika 1, *“Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik”* i Ligjit 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, parashikon se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.*

III.8.2. Në nenin 26 pika 2 dhe 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, parashikohet se: *“2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë

elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentet e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”

III.8.3. Në nenin 32 pika 1 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimi publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik, njoftimin e fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit. Në rastin e procedurave të prokurimit, që zhvillohen ose përfundohen në formë shkresore, ky njoftim publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike.”

III.8.4. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Pas njoftimit të operatorit i kualifikuar i pari në renditje me ofertën ekonomike më të ulët, rezulton që në dokumentacionin e dorëzuar nuk është sjellë pranë autoritetit kontraktor: 1-Vërtetimi i prokurorisë mbi gjendjen gjyqësore si dhe dëshmia e penaltetit sipas formularit të vetëdeklarimit”, pretendimet e këtij të fundit, si dhe nga informacioni i autoritetit kontraktor, KPP gjykon, se afatet e kryerjes së veprimeve procedurale caktohen nga Kodi i Procedurës ose nga ligje të veçanta. Kohëzgjatja në të cilin një akt procedural duhet të realizohet shprehet sipas rastit në ditë, muaj apo vite. Akti nënligjor për rregullat e prokurimit publik, konkretisht VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, afatin e publikimit të njoftimit të fituesit për një procedurë prokurimi e ka llogaritur në ditë dhe konkretisht duke i vendosur një afat maksimal jo më vonë se 7 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave. Nga ana tjetër referuar bazës ligjore të sipërcituar në rastet e procedurave të prokurimit me operatorë ekonomikë të kualifikuar si oferta të suksesshme, autoriteti /enti kontraktor ka detyrimin ligjor që përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike sipas parashikimeve të nenit 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar,

çfarë nënkupton se brenda kësaj periudhe kohore (menjëherë pas përfundimit të vlerësimit, por jo më vonë se 7 ditë) autoriteti kontraktor duhet të komunikojë me ofertuesin për dorëzimin e dokumentacionit dhe vlerësimin e tij me qëllim që nëse përmbushen kushtet të vijohet me publikimin e njoftimit të fituesit. Në rastin konkret referuar parashtrimeve në ankesë se : *“Po me datë 26.11.2024 në seksionin e “Kërkesave nga AK“ në SPE mbërrin njoftimi nga ana e AK për paraqitje dokumentacioni provues në përputhje me “formularin e vetëdeklarimit” me afat datë e nesërme 27/11/2024 pra vetëm 24 orë kohë për dokumenta të cilat nuk janë të disponueshme në çdo moment nga minimumi 3 ditë kohë”* Komisioni gjykon se vërtetë dispozitat e akteve ligjor dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik nuk parashikojnë një afat fiks mbi momentin e dorëzimit të dokumentacionit nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari si ofertë e suksesshme, por referuar dispozitave ligjore në fuqi menjëherë, por jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor për publikimin e njoftimit të fituesit. Nga ana tjetër përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese dhe ato të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik me qëllim verifikimin e tyre dhe publikimin e njoftimit të fituesit. Në këtë kuptim operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet që maksimalisht brenda 7 ditësh nga momenti i përfundimit të vlerësimit të ofertave të dorëzojë në autoritet kontraktor dokumentacionin e kërkuar dhe mbi bazën e vlerësimit të kryer nëse plotësohen kushtet autoriteti të procedojë me hapa të mëtejshëm procedurale siç është publikimi i njoftimit të fituesit. Në rastin konkret pavarësisht pohimeve të operatorit ekonomik ankimues i cili shprehet se *“Me të marrë njoftimin ne si O.E. përgatitëm të gjithë dokumentacionin e disponueshëm dhe aplikuar në e-albania për vërtetimin e OSHEE për “Vërtetim debie” dhe u paraqitëm pranë Prokurorisë dhe Gjykatës Dibër për marrjen e dokumentacionit të vetëdeklaruar. Gjithësesi meqenëse as vërtetimi i debisë nga OSHEE në ealbania as vërtetimet e Prokurorisë dhe Gjykatës nuk ishin gati për datën 27/11/2024 për arsyet e tyre u paraqitëm pranë AK dhe dorëzuam dokumentacionin e disponueshëm. Personeli i AK kur pa se mungonin dokumentacioni i Prokurorisë dhe Gjykatës na thanë “nuk ka problem mund t’i sillni javën tjetër mqs 28-29-30/11 dhe 01/12 ishin ditë pushimi zyrtar” në asnjë moment nuk rezultojnë të provuara nga operatori ekonomik ankimues, pretendimet e mësipërme lidhur me pohimet e punonjësve të autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik *onus probandi incubit actor* (barra e provës i bie kërkuesit), si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: *“në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*. Ndërkohë nga ana e autoritetit kontraktor rezulton e provuar, se dokumentacioni është dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues me datë 27.11.2024 me nr. prot. 5870 dhe ku në fletën e inventarit si dhe në dokumentacionin e paraqitur në autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik Sali Vrenezi P.F mungon vërtetimi i gjendjes gjyqësore të këtij të fundi në *cilësinë e operatorit ekonomik sipas**

parashikimeve të pikës 2/b të dispozitës së sipërpërmendur *“b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;”* detyrim i cili duhej përmbushur duke paraqitur në autoritet kontraktor brenda afatit të caktuar dokumentacionin më sipër (vërtetimi i gjendjes gjyqësore në cilësinë e operatorit ekonomik) bazuar në 26 pika të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për prokurimin publik” i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se : *“6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike...”* Referuar informacionit bashkëlidhur ankesës rezulton se bashkë me ankesën është paraqitur edhe vërtetimi me nr.80 prot., datë 04.12.2024 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër si dhe vërtetimi nr. 1315 regjistri datë 04.12.2024 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për subjektin Sali Vrenezi P.F., pra vërtetime që rezultojnë të lëshuara pas datës 27.11.2024 në të cilën ankimuesi ka paraqitur në autoritet kontraktor dokumentacionin fizik çka provon edhe një herë që këto dokumenta nuk janë dorëzuar në autoritet në datën 27.11.2024. Gjithashtu, referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ si dhe sistemit të prokurimit elektronik nuk rezulton e provuar në asnjë moment që operatori ekonomik ankimues t’i ketë kërkuar autoritetit kontraktor (në cilëndo prej formave, shkresore apo në sistem elektronik) zgjatjen e afatit (përtej atij që ishte vendosur nga autoriteti kontraktor) për dorëzimin e dokumentacionit me qëllim kapërcimin e pengesave të pretenduara nga operatori ekonomik ankimues në lidhje me sigurimin, noterizimin dhe dorëzimin e dokumenteve.

Referuar të gjithë arsytimit më lart KPP gjykon, se operatori ekonomik ankimues pas kualifikimit si i pari, ka dështuar të provojë se ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor vërtetimin e gjendjes gjyqësore në cilësinë e operatorit ekonomik brenda afatit me qëllim që autoriteti kontraktor të vazhdonte me hapat e mëtejshëm proceduralë sipas parashikimeve ligjore.

Sa më lart pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.9. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues Sali Vrenezi P.F për skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të KPP mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të tij, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.10. Lidhur me pretendimet e ankimuesit Sali Vrenezi P.F mbi kualifikimin e operatorit ekonomik Dritan Xheka P.F, në këtë procedurë prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se,

III.10.1. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin Elektronik të Ankesave”.

III.10.2. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në sistemin e ankesave elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.10.3. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet:

1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III.10.4. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë), se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik, me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet të plotësohen dy kushte kumulative:

(legjitimimi *locus standi*), interesi i ligjshëm për të marrë një kontratë, ose dëmtimi apo rreziku për t'u dëmtuar nga një shkelje e pretenduar.

III.10.5. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit, ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës.

Rrjedhimisht, duke qenë se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin Sali Vrenezi P.F, vijon të mbetet i skualifikuar edhe pas shqyrtimit të ankesës në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*), nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi kualifikimin e operatorit ekonomik Dritan Xheka P.F nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik Sali Vrenezi P.F në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-29086-11-12-2024, me objekt: “Blerje lënde djegëse (Dru), Bashkia Bulqizë” me fond limit 6,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 25.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së mësipërme të prokurimit.

3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik Sali Vrenezi P.F.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Fiorent Zguro

